



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 113/2013
Prishtinë, më 02.07.2013, në orën 10:30
Ndërtesa e Kuvendit, sala S–I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha–Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Mungoi: Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi - ZPRK; Darsei Canhasi – INDEP; Agron Demi – GAP; Avni Tusha, Imba Rudaku, Arta Lokaj, Qëndresa Mrasori – praktikantë.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.06.2013;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës, si: Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë për Privatizimin e PTK-së, me arsyetimin se Komisioni ka mbajtur një dëgjim publik dhe tanimë mund të procedohet tutje me këtë çështje.

Deputetët nuk e përkrahen propozimin e kryetarit me arsyetimin se nuk është çështje e urgjente dhe kërkuan që të shqyrtohet në mbledhje të radhës, si pikë e veçantë e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.06.2013;

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 26.06.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave

Kryetari – Tha se nga Qeveria është proceduar projektligji për sistemin e lejeve dhe licencave, projektligji i cili ka dalë si konkluzion i Këshillit për zhvillim ekonomik, i cili ka për qëllim që të këtë një unifikim administrativ sa i për këtë çështjes së lejeve dhe licencave. Dhe hapi debat në parim.

Lutfi Zharku – Tha se qëllimi për çka e parasheh ky projektligj nuk është arritur të normohet me dispozita të qarta. Çështjen e licencave dhe të lejeve vetëm e ka pasqyruar sipërfaqësisht, sepse dihet se kemi edhe ligje të tjera që e rregullojnë këtë fushë. Ai në fund tha se vota e tij në parim do të jetë abstenimi.

Pas debatit Komisioni me 7 (shtatë) vota Për dhe 3(tri) abstenime nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohet në parim Projektligji Nr .04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave.*
- 2. Arsyetimin në seancë plenare në emër të Komisionit e paraqet kryetari Zenun Pajaziti.*

Komisioni e formoi edhe grupin e punës në këtë përbërje si vijon: Myzejene Selmani, raportuese Teuta Sahatqija dhe Sala Berisha – Shala.

4. Te ndryshme Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit,

Zenun Pajaziti